The Human Rights Advisory Panel
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Priština, Kosovo | Email: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

VENDIM

Data e miratimit: 31 mars 2010

Numri i lëndës. 26/08

N.M. dhe të tjerët

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, u takua më 31 mars, 2010
me prezencën e anëtarëve në vijim:

Z. Marek NOWICKI, Kryetar
Z. Paul LEMMENS
Znj.Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga:

Z. Nedim OSMANAGIĆ, Ushtrues detyre i zyrtarit ekzekutiv

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, paraqitur në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të datës 23 mars 2006 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas këshillimeve, përfshirë mjetet elektronike, në pajtueshmëri me Rregullën 13 § 2 të Rregullave të po asaj procedure,

Vendosi si në vijim:

I. FAKTET[1]

1. Ankuesit janë gjithsejt 143 anëtarë nga komuniteti romë, ashkali dhe egjiptian që jetojn në Kosovë (në këtë vendim të referuar si " romët ") të cilët janë apo kanë qenë banor të pesë kampeve të administruara nga UNMIK-u, kampe këto për persona të zhvendosur (PZhV), brenda Mitrovicës së veriut. Të gjithë ankuesit pohojn të kenë vuajtur helmimin me plumb dhe probleme të tjera në llogari të kontaminimit të tokës/dheut përgjatë territoreve të kampit, për shkak të afërsis së këtyre kampeve me shkritoret e Trepçës, kompleksin e minimit dhe/apo në llogari të higjienës së përgjithshme, tejet të varfër, dhe kushteve të jetës në kampe.

2. Të dhënat mjekësore të dorëzuara nga ankuesit, tregojnë një shumëllojshmëri të rezultateve serioze mjekësore, përfshirë: paralizën, infeksion të trurit, sistemin e imunitetit të dobësuar, anemi, humbje e peshës, çrregullim sjelljesh, tension të lartë, alivanosje, shtypje të lartë gjaku, çrregullim dhe dhembje muskujsh njëherish, probleme me veshkë, vjellje, dhëmbje barku, dobësim në të dëgjuar dhe frymëmarrje, lodhje dhe kokëdhembje.

3. Së paku tre persona, supozohet të kenë vdekur, si pasoj e nivelit dëmtues të plumbit në trupat e tyre. Të tjerët dyshohet të kenë vdekur nga sëmundjet që ndërlidhen me kontaminimin me plumb, por në mungesë të testeve të duhura mjekësore dhe/apo autopsive të duhura, këto ankesa ka qenë vështirë të verifikohen. Helmimi me plumb formalisht është diagnostifikuar si shkaktar i sëmundjes së shumë ankuesve.

4. Kushtet mjekësore të vuajtura nga ankuesit dhe thënë t`i jenë mveshur higjienës së varfër dhe kushteve të jetesës në kampe përfshijnë: reumatizëm, shtypje e lartë e gjakut, diabeti, problemet me të dëgjuar dhe vështërsi në frymëmarrje.

5. Më 10 shkurt 2006, Qendra Europiane për të Drejtat e Romëve (QEDR) ka skeduar një kompensim ankese, në emër të ankuesve, nën Procesin Ankesor të Palës së Tretë të Kombeve të Bashkuara.

6. Në tetor 2008, ankuesit kanë marrë një letër nga Zëvendës-Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara për çështje ligjore në të cilën thuhet se " Kombet e Bashkuara, bashkë me agjensionet relevante në Kosovë, vazhdojnë të shqyrtojnë çështjen në fjalë, dhe ne shpresojmë se do të jenë në gjendje të ofrojnë një përgjigje thelbësore në të ardhmen" . Në gusht 2009, ankuesit kanë marrë një letër tjetër nga Ndihmës –Sekretari i Përgjithshëm për Çështje Ligjore, në të cilën thuhet: Shpresojmë të ofrojmë një përgjigje meritore, deri kah fundi i vjeshtës. Duke ditur që shqyrtimi i bërë nga ana e Kombeve të Bashkuara për çështjen në fjalë është një proces i vazhdueshëm, për çka mendojmë se do të ishte e udhës të mos diskutohet tani për tani ".

7. Kërkesa për kompensim qëndron pezull me Procesin Ankesor të Palës së Tretë të Kombeve të Bashkuara, që nga dita e adoptimit të këtij vendimi.

[1] Për përshkrim më të detajuar të fakteve për rastin, shih vendimin e pranueshëm të Panelit të datës 5 qershor 2009, §§ 1-13.

II. ANKUESIT[2]

8. Ankuesit pretendojnë që në llogari të veprimeve të ndryshme dështuese të UNMIK-ut, të shumëfishojnë shkeljen e instrumenteve të ndryshëm ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, në veçanti të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ-së, neni 2,3,6.1,8,13 dhe 14, dhe neni 1 i Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së),Deklaratës Univerzale të të Drejtave të Njeriut (DUDNJ, neni 25.1), Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Politike dhe Civile (KNDPC, nenet, 2,3,6,7,14 dhe 17), Konventës Kundër Torturës dhe Dënimeve, Degradimeve dhe Trajtimeve të tjera Johumane (KKT, neni 2), Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KNDESK, neni 2.2, 11 dhe 12), Konventës Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial (KNEFDR, neni 2 dhe 5), Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve (KDF, neni 2,3,5,6,16,19,23,24,27 dhe 37), Konventës mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (KEFDG, neni 2,3,5.2,12 dhe 14).

III. PROCEDURA PRANË PANELIT

9. Ankesa është prezantuar më 4 korrik 2008 dhe regjistruar po të njëjtën ditë. Ankuesit janë përfaqësuar nga znj. Dianne Post.

10. Paneli ia ka komunikuar rastin Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP-ja) më 24 korrik 2008, duke i dhënë atij mundësinë e komentimit në emër të UNMIK-ut mbi pranueshmërinë dhe bazueshmërinë, në bazë të Paragrafit 11.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 dhe Rregullës 30 të Rregullores së Punës së Panelit.

11. Përmes letrës më datë 18 shtator 2008, PSSP-ja ka adresuar çështjen e pranueshmërisë me një përgjigje për Panelin.

12. Përgjigja e PSSP-së është dorëzuar tek ankuesit për komentim më datën 7 tetor 2008 dhe një përgjigje është marrë më datën 8 tetor 2008.

13. Përmes një vendimi të datës 5 qershor 2009, Paneli ka deklaruar ankesën pjesërisht të pranueshme dhe pjesërisht të papranueshme.

14. Më 11 gusht 2009, PSSP-ja ka kundërshtuar pranueshmërinë e ankesës, bazuar në mos-shterrimin e mjeteve në dispozicion. Kundërshtimi i është komunikuar ankuesve, të cilët kanë kthyer përgjigje më 25 gusht 2009.

15. Më 16 shtator 2009, përgjigjja e ankuesve e 25 gushtit 2009, i është përcjell PSSP-së për komentet e tij.

16. Në ndërkohë, më 23 tetor 2009 Paneli, pas potencimit se më 17 tetor 2009, PSSP ka lëshuar Udhëzimin administrativ nr. 2009/1 që implementon Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi Themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e

[2] Për përshkrim më të detajuar të ankesave, shih vendimin e Panelit mbi pranueshmërinë të dates 5 qershor 2009, §§ 14-17.

Njeriut, ftoi UNMIK-un të dorëzojë komentet në lidhje me ndikimin e atij Udhëzimi administrativ në rastin e tanishëm. Më 30 tetor 2009, Paneli ftoi edhe ankuesit të dorëzojnë komentet e tyre për të njejtin Udhëzim administrativ.

17. PSSP-ja i është përgjigjur kërkesës së 16 shtatorit 2009, për komentet e datës 4 nëntor 2009, të cilat ishin dërguar tek ankuesit për përgjigje. Ankuesit ofruan përgjigjen e tyre në pyetjet e Panelit më 30 tetor 2009 , dhe komentet e PSSP-së me 9 nëntor 2009.

18. Më 18 janar 2010, Paneli shqyrtoi përgjigjen e PSSP-së në letrën e tij të datës 23 tetor 2009. Kjo përgjigje ishte datuar më 30 tetor 2009.

19. Më 16 mars 2010, Paneli kërkoi informata shtesë nga ankuesit. Ata dhanë përgjigje po atë ditë.

IV. KORNIZA RELEVANTE NORMATIVE

20. Derisa ankesa në fjalë ishte ende e pazgjidhur nga Paneli, në pritje të një mendimi meritor, PSSP-ja lëshoi Udhëzimin administrativ nr. 2009/1 më 17 tetor 2009 për Implementim të Rregullores se UNMIK-ut nr 2006/12 mbi Themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut. Paragrafi 2.1, 2.2 dhe 2.3 i atij Udhëzimi administrativ përmban si vijon:

> "2.1. Në çdo fazë të procesimit të ankesës mbi të drejtat e njeriut, Paneli Këshillëdhënës duhet të ekzaminojë të gjitha çështjet e pranueshmëris së ankesës, para shqyrtimit të meritave.
>
> 2.2. Çdo ankesë e cila është apo në të ardhmen mund të bëhet temë e procesit të Ankesave të Palës së Tretë të KB-së apo e procesimeve nën paragrafin 7 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47 mbi Statusin, Privilegjet dhe Imunitetet e KFOR-it dhe UNMIK-ut si dhe personelit të tyre në Kosovë e datës 18 gusht 2000, sipas korrigjimit, duhet gjykuar e papranueshme për arsye se Procesi i Ankesave të Palës së Tretë të KB-së dhe procedura nën paragrafin 7 e Rregullores nr 2000/47 janë mjete të disponueshme në bazë të Paragrafit 3.1 të (Rregullores nr 2006/12).
>
> 2.3 Komentet mbi bazueshmërinë e një shkeljeje të pohuar të të drejtave të njeriut, duhet të dërgohen vetëm atëherë kur Paneli Këshillëdhënës të ketë kompletuar shqyrtimin e asaj kërkese dhe të ketë përcaktuar pranueshmërinë e po asaj kërkese. Nëse çështjet e pranueshmëris së një ankese janë adresuar pas përcaktimit të pranueshmërisë së ankesës nga ana e Panelit Këshillëdhënës dhe pas fillimit të konsiderimit të bazueshmërisë, atëherë Paneli Këshillëdhënës do të suspendojë shqyrtimet mbi bazueshmërinë derisa pranueshmëria e ankesës të jetë ri-shqyrtuar plotësisht dhe të jetë përcaktuar rishtas.

21. Paragrafi 5 i Udhëzimit administrativ nr. 2009/1 parasheh që asnjë ankesë drejtuar Panelit të mos jetë e pranueshme. "nëse është marrë nga Sekretariati i Panelit Këshillëdhënës pas datës 31 mars, 2010 ".

22. Paragrafi 6 parasheh që Udhëzimi administrativ nr. 2009/1 të hyjë në fuqi më 17 tetor 2009, njëherit data e lëshimit të tij, dhe se " do të jetë i aplikueshëm (për) të gjitha ankesat e dërguara Panelit Këshillëdhënës, përfshirë edhe ato të cilat pritet të zgjidhen nga Paneli Këshillëdhënës "

23. Procesi i Ankesave të Palës së Tretë të KB-së, i referuar në Paragrafin 2.2. formon objektin e rezolutës së Asamblesë së Përgjithshëme 52/247 të datës 17 korrik 1998 mbi " Përgjegjësinë e Palës së Tretë: limitimet e përkohshme dhe financiare " (REZ/A/52/247). Për dispozitat relevante të kësaj rezolute, lexo në vijim:

> "5. *Vendos* që limitimet e përkohshme dhe financiare të rregulluara në paragrafet e mëposhtme 8 deri në 11, duhet aplikuar në kërkesat e palës së tretë kundër Organizatës për lëndim personal, sëmundje apo vdekje, për humbje prone apo dëmtim (përfshirë shfrytëzimin jo-konsensual të objekteve) që rezulton nga, apo që mund t`i vishet aktiviteteve të pjesëtarëve të operimeve paqëruajtëse gjatë performimit të detyrave të tyre zyrtare, siç përshkruhet në paragrafin 13 të raportit të Sekretarit të Përgjithshëm (A/51/903);
> 6. *Firmos* këndvështrimin e Sekretarit të Përgjithshëm se përgjegjësia nuk është llogaritur në relacion me kërkesat e palës së tretë, çka rezulton nga apo mund t`i vishet aktiviteteve të pjesëtarëve për operime paqëruajtëse, të dala nga " nevoja vepruese ", siç përshkruhet në paragrafin 14 të raportit të parë të Sekretarit të Përgjithshëm mbi detyrimet e palës së tretë (A/51/389);
> 7. *Poashtu firmos* këndvështrimet e Sekretarit të Përgjithshëm, reflektuar në paragrafin 14 të raportit të tij (A/51/903), në lidhje me kërkesat e palës së tretë që rezultojnë nga mospërfillja e plotë apo sjellja jo-korrekte e personelit të ofruar nga shtetet trupa-kontribuese në operacionet/veprimet paqëruajtëse, dhe kerkon nga ai të raportojë mbi zbatimin e tyre në raportet relevante të performimit;
> 8. *Vendos* që, aty ku angazhohet përgjegjësia e Organizatës ndaj ankesave të palës së tretë kundër Organizatës, rezultuar nga operimet/veprimet paqëruajtëse, Organizata nuk do të paguaj kompensim për ankesat e dorëzuara me gjashtë muaj vonesë pas kohës së përballimit të atij dëmtimi, lëndimi apo humbjeje, por edhe koha e zbulimit nga ana e ankuesit nuk guxon të kaloj një vit pas përfundimit të mandatit të operimit paqëruajtës, me përjashtim të ndonjë rrethane specifike, siç përshkruhet në paragrafin 20 të raportit të Sekretarit të Përgjithshëm (A/51/903), Sekretari i Përgjithshëm mund të pranojë shqyrtimin e një ankese të tillë edhe pas një date të vonuar.
> 9. *Vendos poashtu*, që në respekt të ankesave të palës së tretë kundër Organizatës, për lëndime personale, sëmundje apo vdekje që rezultojnë nga operimet paqëruajtëse, të veprohet si ne vijim:

a) Llojet e kompensueshme të lëndimit apo humbjes, do të kufizohen në bazë të humbjeve ekonomike, siç janë shpenzimet mjekësore dhe rehabilituese, humbja e të ardhurave, humbja e përkrahjes financiare, shpenzimet e transportit, shoqëruar me shpenzimet e lëndimit, sëmundjes apo kujdesit mjekësor, shpenzimet ligjore dhe ato të varrimit;

(*b*) Asnjë kompensim nuk do të jetë i pagueshëm nga Kombet e Bashkuara për humbje jo-ekonomike, siç janë, dhembja dhe vuajtja apo pikëllimi moral, dhe as për dëmtime morale apo ndëshkuese;

(*c*) Asnjë kompensim nuk do të jetë i pagueshëm nga Kombet e Bashkuara për shërbime shtëpiake dhe dëmtime të atij lloji që, sipas mendimit të Sekretarit të Përgjithshëm, është e pamundur të verifikohen ose nuk janë drejtpërdrejtë të ndërlidhura me lëndimin apo vet humbjen në fjalë;

(*d*) Shuma e kompensimit të pagueshëm për lëndim, sëmundje apo vdekje të ndonjë individi, përfshirë llojet e humjes dhe shpenzimet e lartpërshkruara në nënparagrafin *(a)*, nuk duhet të tejkalojnë maksimumin e 50,000 dollarëve të Kombeve të Bashkuara, siguruar, megjithatë, se brenda një kufizimi të tillë, shuma aktuale mbetet të përcaktohet duke i`u referuar standardeve vendore të kompensimit;

(*e*) Në rrethana të veçanta, Sekretari i Përgjithshëm mund të rekomandojë tek Asambleja e Përgjithshme, aprovim të shumës që tejkalon kufizimin prej 50,000 dollarëve, në raste të veçanta, e përcaktuar më lart në nënparagrafin *(d)*, atëherë kur të jenë bërë hulumtime në lidhje me rastin dhe kur Sekretari i Përgjithshëm të ketë në posedim, argumente bindëse për tejkalim të shumës së kufizuar;

10. *Vendos mëtej*, në respekt të kërkesave të palës së tretë, kundër Organizatës, për humbje prone apo dëmtim, që rezulton nga operimet/veprimet paqëruajtëse, kështuqë:

(a) Kompensimi për shfrytëzim jo-konsensual të objekteve, duhet ose të: (i) kalkulohet në bazë të vlerës së duhur të qirasë, të përcaktuar në bazë të çmimit të tregut të qirasë vendore, çmim i cili ka mbizotëruar para se të pozicionohen trupat e operimit/veprimit paqëruajtës, i vendosur nga ekipi teknik hulumtues i para - misionit; apo (ii) të mos tejkalohet kufiri i shumës maksimale të pagueshme për metër katror apo hektar, siç edhe ishte vendosur nga ekipi teknik hulumtues i para–misionit, bazuar në informatat relevante në dispozicion; Sekretari i Përgjithshëm do të vendosë për metodën e duhur të kalkulimit të kompensimit të pagueshëm për shfrytëzim jo-konsensual të objekteve, në konkludimin e hulumtimit teknik para-misionar.

(b) Kompensimi për humbje apo dëmtim të objekteve duhet ose të : (i) kalkulohet në bazë të një vlere të njejtë (barazvlere) të një numri të muajve me vlerën e qirasë, ose me përqindjen fikse të shumës së pagueshme për periudhën e uzurpimit nga ana e Kombeve të Bashkuara; apo (ii) të rregullohet me një përqindje fikse të shumës së riparimit; Sekretari i Përgjithshëm do të marrë vendim për metodën e duhur të kalkulimit të kompensimit të pagueshëm për humbje apo dëmtim të objekteve në konkludimin e hulumtimit teknik para-misionar.

(c) Kurrfarë kompensimi nuk do të paguhet nga ana e Kombeve të Bashkuara për humbje apo dëmtime që, sipas mendimi të vet Sekretarit të Përgjithshëm, është e pamundur të verifikohen apo nuk janë të ndërlidhura drejtpërdrejtë me humbjen apo dëmtimin e objekteve.

11. *Vendos* që:

(*a*) Kompensimi për humbje apo dëmtim të pronës private të palëve të treta nga aktivitetet e operimeve, apo në ndërlidhje me performimin e detyrave zyrtare të stafit nga anëtarët e saj, do të mbulojë shpenzimet e arsyeshme të riparimit apo zëvendësimit;

(*b*) Asnjë kompenzim nuk do të paguhet nga Kombet e Bashkuara për humbje apo dëmtime të cilat, sipas mendimit të Sekretarit të Përgjithshëm, nuk është e mundur të verifikohen apo nuk janë drejtpërdrejt të ndërlidhura me humbjen apo dëmtimin e pronës private;

12. *Kërkesat* e Sekretarit të Përgjithshëm për të marrë masa të nevojshme për zbatim të rezolutës në respekt të marrëveshjeve për status-të-forcave në pajtueshmëri me paragrafin 40 të këtij raporti (A/51/903);

13. *Poashtu kërkon* nga Sekretari i Përgjithshëm të sigurojë që kushtet e referimit të bordeve shqyrtuese vendore të përfshijnë kufizime të përkohshme dhe financiare mbi besueshmërinë e Organizatës, siç është e rregulluar me paragrafë e mësipërme 8 deri 11, dhe që këto borde të bazohen në këto kufizime të përkohshme dhe financare, si bazë e juridiksionit dhe rekomandimeve për kompenzim të kërkesave të palës së tretë kundër Organizatës, të cilat rezultojnë nga veprimet/operimet paqëruajtëse. “

24. Paragrafi 7 i Rregullores së UNMIK-ut n. 2000/47 i datës 18 gsht, 2000 mbi Statusin, Privilegjet dhe Imunitetin e KFOR-it dhe UNMIK-ut si dhe Personelin në Kosovë, referuar në Paragrafin 2.2. të Udhëzimit administrativ nr. 2009/1, thotë:

> “ Kërkesat e Palës së Tretë për humbje të pronës apo dëmtim, lëndim personal, sëmundje apo vdekje, të dala nga apo drejtpërdrejtë të atribuara KFOR-it, UNMIK-ut apo personelit të tyre përkatës dhe të cilat nuk dalin nga “ nevoja vepruese “ e asnjërës, do të rregullohen nga Komisionet e Kërkesave të themeluara nga KFOR-i dhe UNMIK-u, ashtuqë të jenë funksionale “.

V. LIGJI

A. Nëse ankesa gjykohet si e papranueshme

i. Argumentet e palëve

25. Ftuar nga Paneli për të komentuar mbi efektin e paragrafit 2 të Udhëzimit administrativ nr. 2009/1 për rastin në fjalë, UNMIK-u thekson se rasti i ankuesve është temë e " Procesit të Ankesave të Palës së tretë të KB-së nën Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/47 ". Argumenton se paragrafi 2.2 i Udhëzimit administrativ nr. 2009/1 është i aplikueshëm, kështuqë kërkesa gjykohet si e papranueshme. Pritet që Paneli të veprojë në pajtueshmëri me Udhëzimin administrativ dhe të arrijë një definim që zbaton si duhet atë legjislacion.

26. Ankuesit përgjigjen se nxjerrja e Udhëzimit administrativ të UNMIK-ut nr. 2009/1 vetvetiu është një sulm anësor mbi vendimin e Panelit për pranueshmëri të 5 qershorit 2009, i cili shkel parimet themelore të ligjit ndërkombëtar administrativ dhe sundimin e ligjit, përfshirë procesin në pritje, pamundësinë e prapaveprimit, dhe drejtësinë thelbësore. Ankuesit sulmojnë një numër të dispozitave të Udhëzimit administrativ si të papajtueshme në brendësi, të rrëmbyeshëme dhe në shkelje të sundimit të ligjit.

27. Ankuesit poashtu argumentojnë se ankesa e tyre është e pa zgjidhur me Procesin e Ankesave të Palës së Tretë, që nga data 10 shkurt 2006. Ata thonë se vonesa në arritjen e konkludimit të këtyre proceseve, çiftëzohet me aplikimin e menjëhershëm të Udhëzimit administrativ nr. 2009/1 për rastet e pazgjidhura, gjë që sjell një besim të keq ndaj UNMIK-ut, për përpjekje të asgjësimit të çfardo procesi e para së gjithash përpjekje për çvleftësim të kërkesave të ankuesve.

28. Ankuesit më tej argumentojnë se lëshimi i Udhëzimit administrativ, mohon qasjen e ankuesve në mjete, duke shkuar tutje me shkeljet tashmë të pohuara të të drejtave të tyre për një process të drejtë gjyqësor dhe një mjet efikas.

ii. Të gjeturat e Panelit

29. Para se të vazhdohet me shqyrtimin e bazueshmërisë së ankesës, Paneli së pari duhet të shqyrtojë, kundërshtimin e ri të UNMIK-ut mbi pranueshmërinë, në bazë të paragrafit 2.3 të Udhëzimit administrativ nr. 2009/1.

Pyetja mbi ligjshmërinë e Udhëzimit administrativ nr. 2009/1

30. Meqë Paneli mbajti rastin *Balaj II* nr. 320/09, vendimi i datës 12 shkurt 2010, mbetet brenda zgjedhjes së PSSP-së për të vendos skemën rregullative të sistemit ankues para Panelit dhe Paneli nuk ka kurrfarë justifikimi për kontrollim të mundësisë së bazës ligjore të funksionimit të vet sipas standardeve për të drejtat e njeriut.

31. Paneli ripërsërit se, edhe nëse seriozisht vehet në pyetje se a ka PSSP-ja kompetenca për të ndryshuar disa nga parimet bazë që përmban Rregullorja e UNMIK-ut nr 2006/12 përmes një "zbatueshmërie "të udhëzimit administrativ, me qëllim që ligjshmëria e Panelit të mos ketë ndonjë dallim nga modifikimet e bëra nga rregullorja apo udhëzimi administrativ, qëndron fakti se dispozitat e udhëzimit administrativ nr. 2009/1 formojn një pjesë të bazës së funksionimit të Panelit.

32. Me keqardhje, Paneli duhet të konkludojë se nuk egziston asnjë ligjshmëri për t`u marrë me argumentet e ngritura nga ankuesit, në lidhje me jolegjitimitetin e Udhëzimit administrativ nr. 2009/1.

33. Kështuqë, kërkohet nga Paneli të shqyrtojë thelbin e kundërshtimit të bërë nga UNMIK-u.

Kundërshtimet e ngritura nga UNMIK-u

34. Paragrafi 2..2 i Udhëzimit administrativ nr. 2009/1 siguron që çdo ankesë " e cila është apo mund te bëhet në të ardhmen " temë e Procesit për Ankesa të Palës së Tretë, e zbatueshme për UNMIK-un nga Paragrafi 7 i Rregullores nr 2000/47 " do të gjykohet si e papranueshme ", për arsye se ky proces konsiderohet si mjet në dispozicion në kuptimin e Paragrafit 3.1 të Rregullores nr 2006/12.

35. Nën Paragrafin 3.1. të Rregullores nr. 2006/12 adresimi normal do të duhej të ishte nga një ankues për mjetet në dispozicion dhe të mjaftueshme për të përballuar rivendosjen e pohimeve të thyera. Egzistimi i mjeteve në pyetje, duhet të jetë mjaftueshmërisht i sigurt, jo vetëm në teori por edhe në praktikë, dështimi i të cilit shkakton mungesë të përdorimit të duhur dhe efikasitetit (krahaso, me gjithë respektin ndaj kërkesave të shterrimit të mjeteve të brendshme nën Artikullin 35 § 1 të GJEDN-së, Gjyqi Evropian për të Drejtat e Njeriut (Dhoma e Madhe), *Demopoulos dhe Të Tjerët* v. *Turqi*, nrs. 46113/99 dhe tjetra, vendimi i datës 1 mars 2010, § 70, cituar nga GJEDN, *Akdivar dhe Të Tjerët v. Turqi*, vendimi i datës 16 shtator 1996, *Raportet e Aktgjykimeve dhe Vendimeve*, 1996-IV.f. 1210, § 66). Do të ishte normale për Panelin të jetë i kënaqur, meqë Procesi i Ankesave të Palës së Tretë të KB-së, si edhe çdo mjet tjetër që mund të avansohet nga UNMIK-u, " ka qenë efektiv, i disponueshëm në teori dhe praktikë, aktiv në kohë të duhur, dhe mund të thuhet, se ishte i arritshëm, ishte njëri nga proceset që ishte në gjendje të sigurojë dëmshpërblim në respekt të ankesave të (ankuesve) duke ofruar perspektivë të arsyeshme të suksesit " (krahaso, GJEDN, *Akdivar dhe Të Tjerët v. Turqi, aktgjykimi i cituar më lart, f.* 1211, § 68).

36. Paragrafi 2.2 i Udhëzimit administrativ nr. 2009/1 largon këtë ligjshmëri nga Paneli. Kjo dispozitë ka efektin e obligimit të Panelit për të marrë në konsideratë Procesin e Ankesave të Palës së Tretë, si një mjet të arritshëm dhe të mjaftueshëm.

37. Megjithatë, kjo nuk nënkupton se, thjesht fakti që UNMIK-u me ngritjen e një kundërshtimi bazuar në Paragrafin 2.2. të Udhëzimit administrativ nr. 2009/1 paevitueshmërisht dhe pa shkuar më tutje shpie në konkludim se ankesa është e gjykuar si e paparanueshme. Paneli konsideron se, kur një kundërshtim i tillë është ngritur, duhet siguruar nëse objekti i ankesës para Panelit, është i asaj natyre, që mund në mënyrë të arsyeshme t`i japë të drejtën ankesës për t`u marrë me të, brenda Procesit të Ankesave të Palës së Tretë. Do të deklarohej një ankesë e papranueshme vetëm kur sigurohet se ankesa është nga ato që bien *prima facie* brenda fushës së Procesit të Ankesave të Palës së Tretë të KB-së. Në të kundërtën, parandalohet nga shqyrtimi, qoftë kur rezultati i procesit është në mundësi të sigurimit të mjaftueshëm

të dëmshpërblimit në respekt të ankesës para Panelit, apo kur procesi ofron perspektivë të arsyeshme suksesi ankuesve.

38. Procedura e përcaktuar në rezolutën e Asambles së Përgjithshme 52/247 dhe Paragrafi 7 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47 lejon Kombet e Bashkuara, që përmes udhëzimit të saj, të sigurojnë kompensim për kërkesat e rasteve si lëndim personal, sëmundje apo vdekje, humbje të pronës apo dëmtim të saj, të shkaktuara nga veprimet e UNMIK-ut, të cilat nuk janë nxjerrë jashtë nevojës vepruese. Kështuqë, ankesat për shkelje të të drejtave të njeriut të atribuara UNMIK-ut, do të gjykohen të papranueshme nën Paragrafin 2.2. të Udhëzimit administrativ nr. 2009/1 duke u bazuar se ato kanë rezultuar ose në lëndim personal, sëmundje apo vdekje, apo në humbje api dëmtim të pronës. Ankesat në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut që kanë rezultuar në dëmtim të asaj natyre, normalisht nuk do të llogariten në mesin e kërkesave të shterrimit të Procesit të Palës së Tretë të KB-së.

39. Duke i`u kthyer kundërshtimit të UNMIK-ut për rastin në fjalë, Paneli përkujton se ankesa në fjalë ka të bëjë me një situatë skajshmërisht të rëndë me të cilën është ballafaquar i gjithë komuniteti, banorë të mëparshëm të Mahallës së romëve, pjesë e Mitrovicës.

40. Ankesat bazë të deklaruara të pranueshme nga Paneli në vendimin e tij, të datës 5 qershor 2009, janë drejtpërdrejtë të ndërlidhura me zgjedhjen e bërë që në fillim me qëllim të strehimit të PZhV (Personave të Zhvendosur) në kampet në fjalë dhe/apo dështimi për të rivendosur të njëjtit, si dhe ndikimet që pasuan dhe rezultuan në lëndim personal, sëmundje apo vdekje. Paneli konsideron se këto pjesë të ankesës bien *prima facie* nën përgjegjësi të procesit të Ankesave të Palës së Tretë dhe për këtë arsye gjykohen si të papranueshme.

41. Ankesat procedurale të deklaruara të pranueshme nga ana e Panelit, siç janë ankesat në lidhje me shkeljen e aspekteve procedurale të të drejtës për jetë, ndalimit të trajtimeve degraduese dhe johumane, si dhe atyre që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtës për një gjykim të mirfilltë dhe e drejta e një mjeti efektiv, akteve me rëndësi, kalim të situates, e cila është e qartë se nuk ka rezultuar në lëndim personal, sëmundje apo vdekje, por as në humbje të pronës apo dëmtim të saj. Si të tilla, këto pjesë të ankesës nuk janë mbuluar nga Procesi i Ankesave të Palës së Tretë.

42. Megjithatë, Paneli konsideron, se ankesat themelore dhe procedurale që qëndrojn ende të pazgjidhura para Panelit, janë aq shumë të ndërlidhura mes veti sa do të ishte shumë artificiale të ndaheshin, duke rezultuar në ankesa bazike, me të cilat punohet në Procesin e Ankesave të Palës së Tretë të KB-së dhe poashtu si ankesa procedurale me të cilat merret në të njejtën kohë edhe Paneli.

43. Kështuqë, Paneli konsideron se i gjithë ankimi gjykohet i papranueshëm.

B. Efektet e vendimit që ankesa të gjykohet e papranueshme.

44. Paneli konsideron të dobishme të shpegojë efektet e vendimit të tij, duke mbajtur qëndrimin se ankimi gjykohet i papranueshëm.

45. Kërkesat e shterrjes së mjeteve në dispozicion janë nga vet natyra e tyre të kufizuara përkohsisht në pranueshmëri. Efekti i deklarimit të papranueshmërisë në llogari të mos-shterrimit të një mjeti në dispozicion, në parim është i natyrës së ngadalësuar e jo i natyrës së prerë. Kjo do të thotë se një ankues, mund të ridorëzojë ankesën e tij/saj atëherë kur të gjitha proceset e kërkuara të jenë përfunduar/konkluduar. Ky qëndrim është pranuar në rastin e UNMIK-ut në fjalë (këtë rast). Në një shkresë të Drejtorit të Zyrës për Çështje Ligjore të datës 30 tetor 2009, bashkëngjitur letrës së PSSP-së të po asaj date, thuhet se rastet e gjykuara të papranueshme, mbështetur në Paragrafin 2.2 të Udhëzimit administrativ nr. 2009/1, " mund të ridorëzohen nga ana e ankuesve tek (Paneli), pas kompletimit të procesimit të ankesave të tyre të ndërlidhura nën (…..) procesin e Ankesave të Palës së Tretë ".

46. Nëse ankuesit duan të shfrytëzojnë këtë mundësi, atyre normalisht do u kërkohet të përgatisin një ankesë të re për Panelin, sapo të jetë përmbyllur Procesi i Ankesave të Palës së Tretë të KB-së. Sipas shkresës së cekur të Drejtorit të Zyrës për Çështje Ligjore, ankuesit do të mund të bëjnë një gjë të tillë " deri më 31 mars 2010, datë e prerë për dorëzim të ankesave tek (Paneli) " , imponuar nga Paragrafi 5 i Udhëzimit administrativ nr. 2009/1.

47. Megjithatë, nëse nga ankuesit kërkohet të ri-dorëzojnë ankesë pas përmbylljes së Procesit të Ankesave të Palës së Tretë të KB-së, atyre pashmangshmërisht do u ngjallet pakënaqësi për afatin e kufizuar të 31 marsit 2010, për dorëzim të ankesave të reja.Kërkesa për të hulumtuar Procesin e Ankesave të Palës së Tretë të KB-së, në këtë rast do të shuante, aty për aty ankesën dhe do të pamundësonte ri-dorëzimin e ankesave tek Paneli, përkundër faktit se, siç edhe kishte zbuluar Paneli më 5 qershor 2009, ankesa ishte e pranueshme sipas kornizës së zbatueshme rregullative, me rastin e dorëzimit. Një rezultat i tillë do të ofendonte pikëpamjet bazë të drejtësisë. Në kontekstin specifik të heqjes së afatit të caktuar me Udhëzimin administrativ nr. 2009/1, Paneli konsideron se kërkohet një aranzhim specifik, i cili do të mundësonte që ankuesve t`u vazhdohet shqyrtimi i mëtejmë i ankesave të tyre nga ana e Panelit edhe pas kompletimit të Procesit të Ankesave të Palës së Tretë të KB-së, në rast se një gjë e tillë dëshirohet nga Paneli.

48. Paneli vëren se, me gjithë respektin për të gjeturat e tribunaleve të ndryshme ndërkombëtare, në disa rrethana specifike, aplikuesit mund të kërkojnë t`u ofrohet rihapje e të gjeturave, të cilat veç kanë qenë të mbyllura, me rastin e krijimit të rrethanave të reja dhe atëherë kur rihapja e këtyre të gjeturave është në interes të drejtësisë.

49. Është praktikë e zakonshme, për shembull e Gjyqit Evropian për të Drejtat e Njeriut, të godas pikërisht rastet jashtë listës së tij, në bazë të nenit 37 § 1 (c) të KEDNJ, ku për disa arsye objektive nuk është arsyetuar vazhdimi i shqyrtimit të aplikacionit. Në raste të tilla, gjyqi mund të rivendosë shqyrtimin e aplikacionit në listën e rasteve të tij, kur konsiderohet se rrethanat e arsyetojnë një gjë të tillë, bazuar në nenin 37 § 2 të KEDNJ-së (për aplikacione, shih KEDNJ, *Aleksentseva dhe 28* Të Tjerët *v. Rusia*, nrs. 75025/01 dhe tjetra, vendimi i datës 23 mars 2006; KEDNJ, *Jashi v. Gjeorgjia*, nr. 10799/06, vendimi i datës 9 dhjetor 2008).

50. Përndryshe, më 1974, Gjyqi Ndërkombëtar i Drejtësis (GJND) vendosi që *në Rastin e Testeve Nukleare*, në respekt të një deklarate të njëanshëme të vendit

përgjegjës, duke mos pasur ndonjë kundërshti në kërkesën e vendit aplikues, vendosi të mos marrë ndonjë vendim në lidhje me rastin. Për të njëjtin vendim gjyqësor, Gjyqi lejoi vendin aplikues të kërkojë një vlerësim të situatës " në rast se kjo do ndikonte në vendimin gjyqësor. " (GJND-ja, *Zelanda e Re* v. *Franca,* vendimi gjyqësor i datës 20 dhjetor 1974, *Raportet e GJND-së, 1974*, f.457, § 63).

51. Rreth 20 vite më pas, vendi aplikues tentoi të rihapte të gjeturat në lidhje me rastin. GJND-ja shpjegoi se me përfshirjen e fjalëve të lartcituara në vendimin gjyqësor të vitit 1974, nuk do të mund të pretendonte t`i kufizojë qasjen aplikuesit në procedurat ligjore, siç është dorëzimi i një aplikacioni të ri, një kërkesë për interpretim apo kërkesë për rishikim, meqë procedurat e tilla do të mund të hapeshin në çdo rast. Përndryshe " nuk përjashtohet një procedurë specifike " *(Kërkesa për një* v*lerësim të situatës në pajtueshmëri me paragrafin 63 të Vendimit Gjyqësor 1974 në Testet Nukleare, Rasti (Zelanda e Re v. Franca)* urdhëri i datës 22 shtator 1995, *Raportet e GJ.N.D*. f. 288, §§ 52-53).

52. Duke respektuar këto praktika, Paneli konsideron se një "procedurë speciale " e ngjashme duhet të zbatohet në rastin e tanishëm gjithashtu. Në pajtueshmëri me Rregullën 49 të Rregullave të Procedurës së Panelit, të cilat sigurojnë që përgjigjet e paudhëhequra nga këto Rregulla, duhet rregulluar nga Paneli si dhe të mirret vendim që pas përfundimit të Procesit të Ankesave të Palës së Tretë të KB-së, mund të kërkohet nga Paneli rihapja e gjetjeve të tanishme, bazuar në informatat në dispozicion, nëse duhet pranuar apo jo një kërkesë e tillë.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri,

DEKLARON ANKESËN TË PAPRANUESHËME.

Nedim OSMANAGIĆ
Ushtrues Detyre i Zyrtarit Ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryetar